



**Prishtinë, 28 janar 2011**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_338\_2011**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna në dispozitat e Nenit 14 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185;
- Kërkesën zyrtare për amendamentimin e Standardeve të Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit dhe Standardeve të Sigurisë së Operimit;

**në seancën e mbajtur me datë 28 janar 2011, nxori këtë:**

**VENDIM**

- I. Aprovohen** amendamentet e “Standardeve të Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit” dhe “Standardeve të Sigurisë së Operimit”.

**Arsyetim**

- o Në takimin e mbajtur me datë 12.01.2011 të Komisionit për Qeverisjen e Kodeve Teknike/Operacionale-KQKO, KOSTT-i ka paraqitur për shqyrtim kërkesën për amendamentimin e Nenit 2.1.2 të dokumenteve “Standardet të Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit” dhe “Standardet e Sigurisë së Operimit”.
  - o Anëtarët e KQKO-së, pas analizave dhe diskutimeve u pajtuan që propozimet e KOSTT-it për amendamentimin e këtij neni të procedohen për aprovim në ZRRE.
  - o Kërkesa zyrtare për amendamentimin e “Standardeve të Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit” dhe “Standardeve të Sigurisë së Operimit”, është dërguar nga sekretari në emër të KQKO-së, për aprovim në ZRRE me datë 26.01.2011.
- II.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes së versioneve, atëherë do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Blerim Koci, anëtar